



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ERMAL XH. HAMZAJ
ADRESA Rruga: "Pashko Vasa", Pallati
Nr.8, Shk.1, Zyra 5, Kt.2 Njesia
Bashkiake Nr. 5
TEL: 698227426



DEKLARATË NOTERIALE

(DEKLARATË ME PËRMBAJTJE TË TJERA)

Nr. repertori: 4323

Nr. koleksioni: 3195

Tirane më 26/05/2025

1

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë



A2025053150334766308



DEKLARATË NOTERIALE

Sot, në Tiranë më datë 26/05/2025 (dymijë e njëzetë e pesë), përpara meje noter Ermal Xh. Hamzaj, me zyrë në Rr. "Pashko Vasa", P.8, Njësia Bashkiake Nr. 5, Tiranë, u paraqit personalisht me cilësinë e "Deklaruesit": **Shoqëria "EA TOBACCO" Sh.p.k**, regjistruar si person juridik në QKB me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L62002012I, datë 02/08/2016; me seli me adresë Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga "Ismail Qemali", Shkalla 2, Kati 2, Ap.2, përfaqësuar nga **Administratori Z.Ergys Agasi**, atësia Bardhyl, amësia Besa, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, lindur më 22/03/1987, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID me nr. personal I70322075Q; *i cili me vullnet të lirë dhe te plote dhe në njohje të pasojave ligjore që sjell një deklaram i rremë, deklaroi para meje noterit si më poshtë vijon:*

Unë **Ergys Agasi** në cilësinë e administratorit të **Shoqërisë EA TOBACCO sh.p.k** deklaroj se kam nënshkruar në cilësinë e palës blerëse **Kontratë Shitje pasuri e Luajtshme (Kuota Kapitali) nr. 970 rep dhe nr. 713 kol, datë 05.02.2025 – Noter Ermal Xh. Hamzaj**, ku në cilësinë e palws shitëse është Z.Darjo JASHARI.

Objekt i kontratës është shitblerja e 1 (një) kuotë, që përfaqëson 100 % të kapitalit të shoqërisë "ALBANIA TABAK FABRIKA E CIGAREVE" SHPK, më poshtë quajtur "Shoqëria", subjekt tregtar i themeluar sipas legjislacionit Shqiptar, regjistruar ne Qendrën Kombëtare të Biznesit me date 25.06.1998, me NIPT J87824603F, ne pronesi te Z.Darjo Jashari, sipas kushteve te dakortesuara mes paleve ne ate akt noterial.

Me nenshkrimin e kesaj deklarate noteriale une deklaruesi **Ergys Agasi** në cilësinë e administratorit të **Shoqërisë EA TOBACCO sh.p.k** deklaroj se pala shitese **Z.Darjo JASHARI**, e ka plotesuar kushtin sipas nenit 3 dhe nenit 4 ne "Kontratë Shitje pasuri e Luajtshme (Kuota Kapitali) nr. 970 rep dhe nr. 713 kol, datë 05.02.2025 – Noter Ermal Xh. Hamzaj" dhe per pasoje kontrata konsiderohet e permbushur.

Nepermjet kesaj Deklarate Noteriale, jam dakord te behet kalimi i kuotave te shoqerise si dhe regjistrimin e kontrates ne QKB, ne pronesi te blesesit sipas **Kontratë Shitje pasuri e Luajtshme (Kuota Kapitali) nr. 970 rep dhe nr. 713 kol, datë 05.02.2025 – Noter Ermal Xh. Hamzaj**, perkatesisht **Shoqerise "EA TOBACCO" sh.p.k**, dhe deklaroj se nuk do te ngrej pretendime ne te ardhmen per kete.

Kjo Deklaratë Noteriale u hartua në gjuhën Shqipe, në 4 (kater) ekzemplare origjinale, me të njëjtën vlerë ligjore, në një faqe. Deklarata noteriale u përpilua sipas vullnetit deklarueses te mesiperme. Deklarata iu lexua me ze te larte e te qarte personit te mesiperm nga une noteri. Pasi e degjoi, ajo deklaroi se persa me siper është përpiluar plotësisht në përputhje me vullnetin e saj të lirë dhe e nenshkroi atë para meje noterit.

Pas nenshkrimit te saj si me siper, une Noteri e firmosa dhe vertetova deklaraten ne perputhje me kerkesat e ligjit nr. 110/2018, date 20.12.2018 "Për Noterinë".

Gjithashtu deklaruesi me autorizon mua noterin për përdorimin e të dhënave personale të tij të bëra të ditura sa më sipër dhe se të dhënat e përdorura nga unë noteri në këtë dokument do



A2025053150334766308

të jenë konfidenciale dhe vetëm për qëllimin e redaktimit të këtij akti. Përpunimi i të dhënave në akt do të bëhet në respektim të plotë dhe zbatim rigoroz të dispozitave të Ligjit Nr. 124/2024, datë 19.12.2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

DEKLARUESI

Shoqeria EA TOBACCO sh.p.k
Perfaqesuar nga Administratori:

Ergys Agosi



NOTERI

Ermal Xh.HAMZAJ



NOTER
ERMAL XH. HAMZAJ

Ermal Xh. Hamzaj